

VENDIM
Nr. 492, datë 1.8.2012

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR
KRYERJEN E TRANSPORTIT HEKURUDHOR KUFITAR NDËRMJET
TË DYJA VENDEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për kryerjen e transportit hekurudhor kufitar ndërmjet të dyja vendeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha